



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 756 / prot.
12.07.20

Tiranë më, 23.07.2021

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 06, datë 23.07.2021

PËR

**DISA NDRYSHIME E SHITESA NË UDHËZIMIN E PËRGJITHSHËM NR.08, DATË
19.05.2020 "PËR SHPENZIMET PROCEDURIALE PENALE NË PROKURORITË ME
JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM"**

Në mbështetje të neneve 148 pika 1, 148/b shkronja "b" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 1 e 2 shkronjat "b", e "f", 4, 5, 6, 42 shkronja "a", "g", 46 pikat 1, 2, 3 shkronja "ç", e vijues të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neneve 485-487 të Kodit të Procedurës Penale, neneve 11, 12 e vijues të ligjit nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", udhëzimit nr.4 datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor" (i ndryshuar), udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.6 datë 20.08.2019 "Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave e shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi në rastet e dhënies së ndihmës juridike", dhe Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2020" datë 14.06.2021;

UDHËZ O J:

Në udhëzimin e përgjithshëm nr.08, datë 19.05.2020 "Për shpenzimet proceduriale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Neni 13 ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Neni 13

Kriteret për caktimin e tarifave orare tavan për ekspertime komplekse

“1. Në rastet kur ekspertit nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre, në llogaritjen e shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve, zbatohen kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij udhëzimi.

2. Në rastet e kryerjes së ekspertimeve komplekse, që lidhet me nivelin e rëndësisë, vështirësisë dhe pritshmërisë së ekspertimit në ecurinë e hetimeve, ushtrimit të ndjekjes penale dhe zgjidhjes ligjore të çështjes ose me kategori ekspertimesh të përzier (miks) apo me volumin e akteve/dokumentave objekt verifikimi, shqyrtimi e vlerësimi nga ekspertët, për llogaritjen e pagesës të ekspertit/ëve ose caktimin e tarifave orare, krahas kriterëve të përcaktuara në nenin 12 të këtij udhëzimi, vlerësohen tarifat orare nëse ato janë të përcaktuar në aktet ligjore apo nënligjore në fuqi, numri i ekspertimeve të kryera në raste të ngjashme dhe kohëzgjatja e afatit të ekspertimit. Këto element prokurori i çështjes, i vlerëson në konsultim në aspektin metodik/teknik me ekspertin e fushës në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.7/2020¹, dhe paraprakisht negocion me ekspertin/ët e ftuar përkatës për formalizimin e një marrëveshje, duke synuar uljen e tarifës orare, marrëveshje e cila në aspektin administrativ/financiar vlerësohet nga drejtuesi i prokurorisë dhe mund të miratohet prej tij, pas konsultimit në aspektin financiar/buxhetor me kancelarin ose në mungesë të tij me nëpunësin zbatues të asaj prokurorie, të cilët për këtë aspekt informojnë/kërkojnë dhe marrin pëlqimin e Sekretarit të Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Ekspertit që kryen ekspertime të veçanta dhe/ose komplekse nuk mund t'i caktohet për të ofruar ekspertizën e tij në më shumë se 30 % të numrit të çështjeve për të cilat është kërkuar e njëjta lloj ekspertize brenda një viti kalendarik në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

Neni 2

Në neni 30, pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Një kopje e "Procesverbalit për shpenzimet procedurale në hetimet paraprake" administrohet në Zyrën e Financës të prokurorisë përkatëse, ku ndodhen dhe urdhër pagesa, fatura ose dokumenta të tjera provuese të shpenzimeve procedurale, të dhëna të cilat sipas listimit të veprave penale, zërave dhe llojeve të shpenzimeve në procesverbalin përkatës, mbahen nga nëpunësi/specialist i financës në “Regjistrin e shpenzimeve procedurale penale” sipas modelit lidhja nr.2, bashkëlidhur”.

Neni 3

Në nenin 36 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Paragrafi i parë ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti raportohen periodikisht, për çdo procedim penal, në shumën/vlerën totale në rubrikën përkatëse të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjes, me fillimin e funksionimit të tij.”

2. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

¹ Shih udhëzimin e përgjithshëm nr.7/2020 datë 13.05.2020 “Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës”

“2. Zyrat e Financës në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm raportojnë periodikisht shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti, sipas veprave penale e zërave përkatëse për çështjet e përfunduara dhe vlera/shuma totale e tyre, për periudhat 3, 6, 9 mujore e vjetore, në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financës në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila përllëgarit kostot e shpenzimeve procedurale penale sipas veprave penale e zërave përkatëse për procedimet penale të përfunduara dhe vlera/shuma totale e tyre sipas prokurorive.”

Neni 4

Neni 37, ndryshohet, si më poshtë:

“Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit² dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit, nëpunësve të prokurorisë dhe/ose drejtuesit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, sipas ligjit.”

Neni 5

Në nenin 38, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas togfjalëshit “...strukturat përkatëse,” shtohet togfjalëshi “...kancelarët, nëpunësit zbatues (sektori financës) dhe/ose nëpunësit/specialistët përkatës pranë prokurorive përkatëse...”

2. Pika 2 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“2. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm ngarkohen drejtuesit e prokurorive, kancelarët dhe nëpunësit zbatues (sektori i financës) në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm³, prokurori/personeli i caktuar pranë Drejtorisë së Koordinimit Institucional dhe Sekretari i Përgjithshëm, në Prokurorinë e Përgjithshme.”

Neni 6

Pas nenit 38, shtohet neni 38/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 38/1

Dispozitë kalimtare

“1. Plotësimi dhe raportimi i të dhënave në “Regjistrin e shpenzimeve procedurale penale” sipas modelit lidhja nr.2, bashkëlidhur, sipas parashikimeve në nenin 2 që shton pikën 4 në nenin 30 dhe në nenin 3 që shton pikën 2 në nenin 36 të udhëzimit, fillon nga data 1 janar 2021.”

Neni 7

² Shih, nenin 148/d paragrafi 1 i Kushtetutës dhe nenet 101 pika 1 shkronja “a” “b” dhe 102 pika 1 shkronjat “c” “ç”, “d” “dh”, “e”, “g”, “i”, “j”, “nj”; pika 2 shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit nr.96/2016, i ndryshuar me ligjin nr.48/2019 dhe neni 89 e vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

³ Shih po aty, nenin 43 shkronja “dh”.

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA



REGJISTËRI I SHPENZIMEVE PROCEDURIALE PENALE

LIDHJA 2

[illegible]

PU- çështja është pushuar me vendim të prokurorit dhe/ose gjykatës

DGG- çështja e dërguar për gjykim

PEZ- çështja është pezulluar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr.756 prot.

Tiranë më, 19.05.2020

I PËRDITËSUAR

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.08/2020¹

**PËR
PËR SHPENZIMET PROCEDURALE PENALE NË PROKURORITË ME JURIDIKSION TË
PËRGJITHSHËM**

(Ndryshime/shtesa me Udhëzimin e Përgjithshëm nr.06/2021²)

Në mbështetje të neneve 148 pika 1, 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 1 e 2 shkronjat “b”, e “f”, 4, 5, 6, 42 shkronja “a”, “g”, 43 shkronja “dh”, 46 pikat 1, 2, 3 shkronja “ç”, 47, 48 e vijues të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 485-487 të Kodit të Procedurës Penale, neneve 11, 12 e vijues të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, udhëzimit nr.4 datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor” (i ndryshuar), udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.6 datë 20.08.2019 “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave e shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi në rastet e dhënies së ndihmës juridike”, dhe Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2020” datë 14.06.2021

U D H Ë Z O J:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

¹ Shih, udhëzimi i përgjithshëm i PP nr.8, datë 19.05.2020 me të njëjtin titull, i përditësuar;

² Shih, udhëzimi i përgjithshëm i PP nr.6, datë 23.07.2021 “Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.08, datë 19.05.2020 “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi të përgjithshëm është unifikimi i procedurave dhe tarifave për mënyrën e llogaritjes dhe dokumentimin e shpenzimeve procedurale penale të parapaguara nga shteti në fazën e hetimeve paraprake në prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, si dhe për marrjen e masave në zbatim të vendimeve gjyqësore për pagimin e detyrimeve të caktuara për shpenzimet procedurale penale.

Neni 2

Objekti

1. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë:

a) Standartizimi i procedurave dhe i tarifave për mënyrën e llogaritjes dhe dokumentimin e shpenzimeve procedurale penale që parapaguhet nga shteti, për veprimet procedurale të kryera sipas ligjit³ nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore në fazën e hetimeve paraprake.

b) Përcaktimi i shpenzimeve procedurale penale të tjera të dokumentuara rregullisht gjatë hetimeve paraprake.

c) Përcaktimi i mënyrës së administrimit të dokumentacionit dhe shpërblimit/pagesës për secilin subjekt nga zyra e financës në prokurori.

ç) Përcaktimi i masave dhe veprimeve procedurale që merren nga prokurori për, -kërkimin e sekuestros konservative në fazën e hetimeve paraprake, -kërkimin në diskutimet përfundimtare lidhur me disponimin e gjykatës për pagimin e shpenzimeve procedurale, dhe -disponimin e prokurorit në urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal të formës së prerë për shpenzimet procedurale penale.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë udhëzim, termat/emërtimet kanë kuptimet si më poshtë:

1. “Prokurori me juridiksion të përgjithshëm” janë prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm⁴.

2. “Shpenzime procedurale penale” janë shpenzimet e parapaguara nga shteti në të gjitha fazat e procedimit (*për këqyrjet, eksperimentet, ekspertimet, njoftimet, për mbrojtësin e caktuar kryesisht*

³ Shih, nenin 485 pikat 2 e 3 të Kodit të Procedurës Penale

⁴ Shih, nenin 2 shkronja “d” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

dhe çdo shpenzim tjetër i dokumentuar rregullisht), për të cilët me vendimin përfundimtar të gjykatës caktohet detyrimi për pagimin e shpenzimeve të parapaguara shtetit⁵.

3. “Shpenzime të dokumentuara rregullisht” janë, por pa u kufizuar vetëm në to, shpenzimet dhe pagesat sipas tarifave e kriterëve të përcaktuara në akte nënligjore⁶ në fuqi, për veprime dhe/ose shërbime të ofruara për përkthime, ekspertime, mbrojtje të detyrueshme nga shteti, njoftime dhe mbulimin e shpenzimeve të dëshmitarëve/deklaruesve dhe/ose viktimave.

4. “Ndhimë juridike” është shërbimi juridik falas dhe shërbime të tjera të parashikuara në ligj⁷, për personat që përmbushin kriteret ligjore⁸, të cilëve u garantohet/paguhet nga shteti.

5. “Përfjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore” është një formë e ndihmës juridike falas për përfjashtimin nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore ose procedurale penale, me vendim të organit procedurës/gjykatës kompetente, në rastet kur plotësohen kriteret ligjore⁹.

Neni 4

Parime për shpenzimet procedurale penale

1. Shpenzimet procedurale penale parapaguhën nga shteti, me përfjashtim të atyre të parashikuara me ligj.

2. Shpenzimet procedurale penale nuk mund t’i ngarkohen të pandehurit kur çështja pushohet me arsyetimin se del qartë se fakti nuk ekziston, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, dhe i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale.

3. Shpenzimet procedurale për përsëritjen e akteve të deklaruara të pavlefshëm në fazën e hetimeve paraprake, kur faji është i organit procedues (*oficerit të policisë gjyqësore, prokurorit ose gjykatës*), nuk mund t’i ngarkohet të pandehurit.

⁵ Shih, nenin 485 pika 2 të K.Pr.Penale.

⁶ Shih -Udhëzimi nr.4 datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor” (i ndryshuar);

-Udhëzimi i Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë nr.3165 datë 12.05.2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”,

-Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë nr.1134/1 datë 23.03.2006 dhe nr.1331/1 datë 16.03.2006 “Për miratimin e tarifave për veprimet dhe shërbimet që ofron Instituti i Mjekësisë Ligjore”;

-Urdhri nr. 3644 datë 7.12.2001 i Ministrit të Rendit Publik⁶, bashkëlidhur shkresa e Institutit të Policisë Shkencore nr. 555 datë 9. 10. 2002 me tarifat e ekspertimeve kriminalistike;

- Urdhri i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë nr.1284/3, datë 16.3.2005 “Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike”, F.Z nr.extra datë 27/12/2007.

⁷ Shih, nenin 8 e vijues të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

⁸ Shih, po aty nenet 11, 12 e vijues të këtij ligji.

⁹ Shih, po aty nenet 25, 26, 27 e 28.

KREU II

SHPENZIMET E DOKUMENTUARA DHE TË VEÇANTA

Neni 5

Shpenzimet në hetimet paraprake

Në fazën e hetimeve paraprake, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, për çdo procedim penal, administrojnë shpenzimet procedurale penale të dokumentuara rregullisht dhe llogarisin e administrojnë shpenzimet procedurale për veprime dhe/ose shërbime të veçanta të ofruara sipas llojeve, të cilët parapaguhën nga shteti, sipas tarifave dhe kriterëve të përcaktuara në ligj¹⁰, aktet nënligjore¹¹ dhe në këtë udhëzim.

SEKSIONI I PARË

SHPENZIMET E DOKUMENTUARA

Neni 6

Shpenzimet për këqyrjet

Në shpenzimet për këqyrjet përfshihen shpenzimet e dokumentuara që janë kryer për këqyrjet e vendeve, përfshirë vendin e ngjarjes, këqyrjet e personave, sendeve dhe kufomave¹².

Neni 7

Shpenzimet për eksperimentet

Në shpenzimet për eksperimentet përfshihen shpenzimet e dokumentuara që janë kryer për eksperimentet lidhur me verifikimin e mundësisë së të parit, dëgjimit ose kryerjes së disa veprimeve të caktuara¹³ rast pas rasti, siç mund të jenë verifikimi i mekanizmit të kryerjes së veprës penale në

¹⁰ Shih, neni 485 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale.

¹¹ Shih, shënimet fundore në pikën 4 më sipër.

¹² Shih, nenet 198-201 të K.Pr.Penale;

¹³ Shih, po aty nenet 176-177;

vendin e ngjarjes apo përcaktimi i drejtimit të qitjes në vendin e ngjarjes për vepra penale të kryera me armë zjarri dhe veprime hetimore të tjera sipas metodikave të veçanta në kryerjen e eksperimentit.

Neni 8

Shpenzimet për ekspertimet

1. Në shpenzimet për ekspertimet e dokumentuara përfshihen:

- a) Shpenzimet për ekspertimet kriminalistike që janë kryer, të llogaritur sipas llojit, mbështetur në tarifat e ekspertimeve kriminalistike të Institutit të Policisë Shkencore në fuqi¹⁴, bashkëlidhur.
- b) Shpenzimet për shërbimet mjeko-ligjore që janë kryer, të llogaritur sipas llojit, mbështetur në tarifat e shërbimeve mjeko-ligjore të Institutit të Mjekësisë Ligjore në fuqi¹⁵, bashkëlidhur.
- c) Shpenzimet e ekspertimit të mbrojtjes kundër zjarrit (MKZ) që janë kryer, të llogaritur sipas llojit, mbështetur në tarifat e shërbimeve të Mbrojtjes Kundër Zjarrit në fuqi¹⁶, bashkëlidhur.
- ç) Shpenzimet e çdo lloji ekspertimi tjetër më fusha të posaçme teknike, shkencore ose kulturore sipas tarifave të përcaktuara për kryerjen e tyre.

Neni 9

Shpenzimet për njoftimet

1. Në shpenzimet për njoftimet¹⁷ përfshihen shpenzimet e dokumentuara për njoftimin e deklaruesit, viktimës, ekspertit, perkthyesit, paditësit civil në procesin penal, të pandehurit, personit nën hetim (person fizik apo person juridik), si dhe mbrojtësit, në format dhe/ose nga organet përkatëse nëpërmjet:

- a) Shërbimit postar;
- b) Telefonit të bërë nga sekretaria e prokurorisë ose nga policia gjyqësore e shoqëruar me aktin përkatës;
- c) Letër rekomande me lajmërim marrje, brenda ose jashtë vendit;

¹⁴ Shih, urdhrin nr. 3644 datë 7.12.2001 të Ministrit të Rendit Publik¹⁴, bashkëlidhur shkresa e Institutit të Policisë Shkencore nr. 555 datë 9. 10. 2002 me tarifat e ekspertimeve kriminalistike, në fuqi.

¹⁵ Shih, Urdhrin e Përbashkët të Ministrit të Drejtësisë Nr.1331/1 Prot, datë 16.03.2006 dhe Ministrit të Financave Nr.1134/1 Prot datë 23.02.2006 “Për miratimin e tarifave për veprimet dhe shërbimet që ofron Instituti i Mjekësisë Ligjore”, bashkëlidhur.

¹⁶ Shih, pikën 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për tarifat e shërbimeve, që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, ndaj shtetasve dhe personave, juridike e fizike, vendas e te huaj”, bashkëlidhur.

¹⁷ Shih, nenet 132, 133, 134, 135, 137, 138, 140, 140/a, 142 paragrafi 1 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

ç) Shpalljes publike, brenda apo jashtë vendit ose afishimit në faqen elektronike të Qendrës Kombëtare të Biznesit për persona juridik;

d) Njoftimit nga policia gjyqësore në vendbanimin apo qëndrimin, ose në vendin e punës apo në selinë e personit juridik;

dh) Njoftimit nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme i personave të huaj që gëzojnë imunitet.

Neni 10

Shpenzimet për mbrojtjen e detyrueshme

1. Në shpenzimet për avokatët në rastet kur kërkohet mbrojtja e detyrueshme e paguar nga shteti, përfshihen shpenzimet e dokumentuara rregullisht:

a) Për shërbimet e kryera nga mbrojtësi i caktuar/zgjedhur sipas ligjit¹⁸ nga organi procedues, në listën e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatisë, sipas tarifave në fuqi¹⁹ të shërbimit për shqyrtimin e shkresave/akteve procedurale dhe mbrojtjen e detyrueshme të pandehurit apo personit nën hetim ose për ndihmën juridike falas të viktimës²⁰.

2. Shërbimet e kryera nga avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, të cilët sipas ligjit²¹, ofrojnë ndihmë juridike dytësore në fazën e hetimeve, për kategoritë e veçanta ose për përfitues me të ardhura/pasuri të pamjaftueshme.

¹⁸ Shih, nenin 49 pika 1 shkronjat “b”, “c”, “ç”, “dh”, “e”, “ë”, pika 2 e 3 dhe neni 58 pika 1 shkronja “c” të K.Pr.Penale.

¹⁹ Shih, urdhri i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë nr.1284/3, datë 16.3.2005 “Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike”, F.Z nr.extra date 27/12/2007.

²⁰ Shih, po aty, urdhrin e përbashkët nr.1284/3, datë 16.3.2005 të Ministrit të Drejtësisë me Kryetarin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

²¹ Shih, nenin 49 pika 7 dhe nenin 49/a të K.Pr.Penale në lidhje me ligjin nr.111/2015 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, e cili në nenet 18, 19 pika 1, 3, 20 pika 1 e 21 parashikojnë:

-Neni 18 “Dhënia e ndihmës juridike dytësore” parashikon:

“Ndiurma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të këtij ligji.”

-Neni 19 “Kërkesa për ndihmë juridike dytësore” në pikën 1 parashikon:

“1. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet nga personi i interesuar personalisht ose me anë të shërbimit postar pranë gjykatës ose organit procedues që fillon hetimet..., sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural.”

-Neni 20 “Paraqitja e kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe organi kompetent për shqyrtimin e saj” në pikën 2 parashikon:

Shpenzimet për rastet e dhënies së ndihmës juridike falas

1. Në shpenzimet për dhënien e ndihmës juridike falas që i afrohet kategorive të veçanta²² ose përfituesve me të ardhura/pasuri të pamjaftueshme²³ përfshihen pagesat e shpenzimeve të

“2. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore e të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare paraqitet pranë organit procedues që fillon hetimet, sipas nenit 21 të këtij ligji.”

-Neni 21 “Procedura e dhënies së ndihmës juridike dytësore të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare” parashikon:

1. Në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet nga i pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare, organi procedues që fillon hetimet shqyrton menjëherë nëse përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.

2. Nëse organi procedues që fillon hetimet vlerëson se kriteret janë përmbushur, cakton menjëherë një avokat mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe njofton menjëherë personin, të cilit i ofrohet ndihmë juridike dytësore, si dhe avokatin e caktuar mbrojtës.

3. Vendimi për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore jepet i arsyetuar dhe i njoftohet kërkuarit dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

4. Kërkuar mund ta kundërshtojë vendimin e organit procedues për rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, me padi në gjykatën penale të shkallës së parë, kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.

5. Gjykata shqyrton çështjen me një gjyqtar, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit brenda 5 ditëve nga marrja dijeni. Gjykata e apelit e shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton rregullat dhe procedurat që ndiqen nga organi procedues që fillon hetimet, për caktimin mbi bazë të parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës dhe zëvendësimin e tij nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal.

7. Rregulla të hollësishme që lidhen me garantimin e mbrojtjes së detyrueshme nga institucionet e parashikuara në këtë ligj, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, miratohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.”

²² Shih, nenin 11 “Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike”, që parashikon:

“Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

a) viktimave të dhunës në familje;

b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;

c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;

ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;

d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;

f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;

g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitim të zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;

gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;

h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

dokumentuara rregullisht për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend, sipas përcaktimeve në ligj²⁴ dhe aktet nënligjore²⁵.

2. Pagesat, në rastet kur gjykata ka vendosur përjashtimin nga pagesa e shpenzimeve procedurale në zbatim të ligjit²⁶, kryhen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas²⁷, sipas rregullave dhe procedurës së përcaktuar në udhëzimin përkatës të Ministrit të Drejtësisë²⁸.

SEKSIONI I DYTË

SHPENZIMET DHE PAGESAT E EKSPERTËVE²⁹

Neni 12

dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;

e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullneshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;

ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;"

²³ Shih, po aty nenin 12 "Përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme", që parashikon:

"1. Të drejtën për të përfutuar ndihmë juridike e ka çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile.

2. Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, sipas kuptimit të pikës 1, të këtij neni, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuar për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

3. Të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, sipas kuptimit të pikës 1, të këtij neni, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

4. Nëse një person, i cili jeton në një familje, kërkon ndihmë juridike dytësore për një çështje kundër një anëtar tjetër të së njëjtës familje, rregulli i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, nuk do të zbatohet. Në këtë rast, të ardhurat e këtij personi konsiderohen të pamjaftueshme, sipas pikës 1, të këtij neni, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

5. Pasuria e një personi konsiderohet e pamjaftueshme, sipas pikës 1, të këtij neni, nëse vlera e saj në total nuk tejkalon vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi."

²⁴ Shih, nenin 485 të K.Pr.Penale dhe nenet 11,12,24 e vijues të ligjit nr.111/2015.

²⁵ Shih, udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë nr.6 datë 20.08.2019 "Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi në rastet e dhënies së ndihmës juridike".

²⁶ Shih, nenet 11, 12, 25 e vijues të ligjit nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"

²⁷ Shih, po aty nenin 8 e vijues të këtij ligji.

²⁸ Shih, udhëzimin nr.6, datë 20.08.2019 "Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi në rastet e dhënies së ndihmës juridike".

²⁹ Shih, Udhëzimin nr.4 datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor" i ndryshuar, me Udhëzimin nr.1 datë 6.03.2019 të Këshillit të Ministrave.

Kriteret e përcaktimit të shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve

1. Në fazën e hetimeve paraprake, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, thërret ekspertë në një procedim penal, mbështetur në të dhënat e Regjistrit Elektronik të Ekspertëve³⁰, që administrojnë dhe vë në dispozicion Ministria e Drejtësisë, sipas kriterëve të përcaktuara me aktin normativ përkatës³¹.

2. Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, thërret ekspertë jashtë Regjistrit Elektronik të Ekspertëve, në rastet kur për nevojat e procesit, eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licensimin e tyre³².

3. Caktimi i shpenzimeve që u takojnë ekspertëve bëhet në bazë të kushteve të mëposhtme:

a) Kur eksperti banon në një largësi deri në 100 km nga prokuroria ose policia gjyqësore ku është thirrur për të kryer ekspertizën, trajtimi financiar i tij përfshin vetëm shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.

b) Kur eksperti banon në një largësi mbi 100 km nga prokuroria ose policia gjyqësore ku është thirrur për të kryer ekspertizën, atij i përballohen shpenzimet e mëposhtme:

i) Dietë ditore, jo më shumë se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, kur ekspertiza zgjat më shumë se një ditë. Për efekt të llogaritjes së dietës, në këtë rast, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë;

ii) Shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me kuponin tatimor, por jo më shumë se 3 000 (tre mijë) lekë, për çdo natë;

iii) Shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.66, datë 27.2.2007 të Këshillit të Ministrave "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve", të ndryshuar.

4. Pagesa për punën e kryer për ekspertimin nga eksperti i licencuar nuk mund të tejkalojë shumën 40.000 (dyzet mijë) lekë.

5. Në rastet kur eksperti caktohet nga gjykata në cilësinë e organit procedues, shpenzimet procedurale penale parapagohen nga gjykata përkatëse.

³⁰ Shih, Udhëzimin nr.10619 datë 19.10.2018 i Ministrisë të Drejtësisë "Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të Regjistrit Elektronik për Ekspertët" i ndryshuar, me Udhëzimin nr.7 datë 27.12.2019 të Ministrisë të Drejtësisë.

³¹ Shih, pikën 3 të ndarjes I të Udhëzimit nr.4 datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor" i ndryshuar, me pikën 1 të Udhëzimit nr.1 datë 6.03.2019 të Këshillit të Ministrave.

³² Shih, po aty pikën 4 të ndarjes I.

Neni 13

Kriteret për caktimin e tarifave orare tavan për ekspertime komplekse

(Ndryshuar me nenin 1 të udhëzimit të përgjithshëm nr.06/2021)

1. Në rastet kur eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre, në llogaritjen e shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve, zbatohen kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij udhëzimi.

2. Në rastet e kryerjes së ekspertimeve komplekse, që lidhet me nivelin e rëndësisë, vështirësisë dhe pritshmërisë së ekspertimit në ecurinë e hetimeve, ushtrimit të ndjekjes penale dhe zgjidhjes ligjore të çështjes ose me kategori ekspertimesh të përzier (miks) apo me volumnin e akteve/dokumentave objekt verifikimi, shqyrtimi e vlerësimi nga ekspertët, për llogaritjen e pagesës të ekspertit/ëve ose caktimin e tarifave orare, krahas kriterëve të përcaktuara në nenin 12 të këtij udhëzimi, vlerësohen tarifat orare nëse ato janë të përcaktuar në aktet ligjore apo nënligjore në fuqi, numri i ekspertimeve të kryera në raste të ngjashme dhe kohëzgjatja e afatit të ekspertimit. Këto element prokurori i çështjes, i vlerëson në konsultim në aspektin metodik/teknik me ekspertin e fushës në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.7/2020³³, dhe paraprkishtë negocion me ekspertin/ët e ftuar përkatës për formalizimin e një marrëveshje, duke synuar uljen e tarifës orare, marrëveshje e cila në aspektin administrativ/financiar vlerësohet nga drejtuesi i prokurorisë dhe mund të miratohet prej tij, pas konsultimit në aspektin financiar/buxhetor me kancelarin ose në mungesë të tij me nëpunësin zbatues të asaj prokurorie, të cilët për këtë aspekt informojnë/kërkojnë dhe marrin pëlqimin e Sekretarit të Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Ekspertit që kryen ekspertime të veçanta dhe/ose komplekse nuk mund t'i caktohet për të ofruar ekspertizën e tij në më shumë se 30 % të numrit të çështjeve për të cilat është kërkuar e njëjta lloj ekspertize brenda një viti kalendarik në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

Neni 14

Dokumentacioni i kërkuar për shërbimin e ofruar nga eksperti

1. Eksperti i angazhuar për herë të parë është i detyruar që në prokurori të dorëzojë këto dokumente:

- a) Certifikatën e regjistrimit të veprimtarisë;
- b) Certifikatën e numrit fiskal;
- c) Kopjen e llogarisë bankare në emër të tij, sipas rastit person fizik ose person juridik;

³³ Shih udhëzimin e përgjithshëm nr.7/2020 datë 13.05.2020 "Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës"

- ç) Kopjen e letërnjoftimit;
- d) Kopjen e licensës apo dokumentacioni që vërteton njohuritë në fushën përkatëse.

Neni 15

Urdhri për shpërblimin e ekspertit

1. Pas përfundimit të ekspertimit, me dorëzimin e aktit të ekspertimit në sekretarinë e prokurorisë, prokurori i çështjes nxjerr urdhrin për shpërblimin e ekspertit të caktuar.
2. Urdhri i shpërblimit nënshkruhet nga prokurori i çështjes dhe drejtuesi i prokurorisë përkatëse.

Neni 16

Fatura shoqëruese e urdhrin

1. Fatura e ekspertit duhet të përmbajë të dhëna:
 - a) numrin e faturës;
 - b) datën e faturës;
 - c) emrin e lëshuesit të faturës (emri i ekspertit/biznesit);
 - ç) numrin e llogarisë bankare në emër të ekspertit/biznesit tij;
 - d) numrin fiskal të biznesit;
 - dh) emrin e prokurorisë dhe seksionit përkatës, shërbimin e ofruar dhe numrin e çështjes;
2. Fatura që të jetë e zbatueshme duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur, me ngjyrë të kaltër (vula duhet të jetë në emër të ekspertit ose biznesit) e pastër dhe jo e korrigjuar.

SEKSIONI I TRETË

SHPENZIMET PËR DEKLARUESIT OSE VIKTIMAT

Neni 17

Kriteret e përcaktimit të shpenzimeve dhe pagesave për deklaruesit ose viktimat

1. Në fazën e hetimeve paraprake, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore thërret dhe pyet shtetas në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale (deklarues) ose në cilësinë e viktimës, të cilët kanë të drejtë për mbulimin e shpenzimeve për deklarimet e dhëna.

2. Caktimi i shpenzimeve, që u takon deklaruesve, bëhet, si më poshtë vijon:

a) Kur deklaruesi/viktima banon në një largësi deri në 100 km nga prokuroria ose policia gjyqësore ku është thirrur për të dhënë shpjegime në cilësinë e personit që kanë dijeni për veprën penale, mbulimi i shpenzimeve të përfshijë vetëm shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifat përkatëse sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.307, datë 20.7.1992 të Këshillit të Ministrave "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve", bashkëlidhur.

b) Kur deklaruesi banon në një largësi mbi 100 km nga prokuroria ose policia gjyqësore ku është thirrur për të deklaruar, atij i përballohen shpenzimet e mëposhtme:

i) Dietë ditore, në masën jo më shumë se 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë;

ii) Shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me kuponin tatimor, por jo më shumë se 3000 (tre mijë) lekë, për çdo natë;

iii) Shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.307, datë 20.7.1992 të Këshillit të Ministrave "Për tarifat e transportit të udhëtarëve".

c) Kur deklaruesi largohet nga vendi i punës, shpërblehet në vlerë të barabartë me pagën ditore të ndërprerë. Shpërblimi kërkohet nga deklaruesi me anë të paraqitjes së një dokumenti me karakter vërtetues të vendit të punës dhe vlerës së pagës.

3. Nuk gëzojnë të drejtën e pagesës për deklarimet e dhëna të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit apo të paraburgosurit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Neni 18

Dokumentacioni dhe urdhri për shpërblimin e deklaruesit/viktimës

1. Deklaruesi dhe/ose viktima brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e veprimit procedural për të cilin është kërkuar prezenca, paraqet pranë prokurorit të çështjes dokumentet tatimore për shërbimet e ofruara dhe, sipas rastit, dokumentacionin vërtetues, si vijon:

a) Fatura/bileta tatimore për shpenzimet e transportit;

b) Fatura tatimore për shpenzimet e fjetjes;

c) Dokumentacion ligjor me karakter vërtetues për vlerën e pagës të vendit të punës;

2. Mosparaqitja e dokumentave tatimore nga e ana e deklaruesit/viktimës sipas përcaktimeve të legjislacionit për tatimet përbën shkak për moskryerjen e pagesës.

3. Prokurori i çështjes urdhëron kompensimin, i cili miratohet me nënshkrimin e drejtuesit të prokurorisë përkatëse.

SEKSIONI I KATËRT

DOKUMENTIMI I SHPENZIMEVE PËR MBROJTJEN E DETYRUESHME

Neni 19

Dokumentacioni për shpërblimin e mbrojtësit

1. Avokati mbrojtës me shpenzimet e shtetit që është i angazhuar për herë të parë është i detyruar që të dorëzojë në prokurorinë përkatëse dokumentet ligjore:

- a) Certifikata e regjistrimit të veprimtarisë dhe të avokatisë;
- b) Certifikata e numrit fiskal;
- c) Kopja e llogarisë bankare në emër të biznesit;
- d) Kopja e letërnjoftimit.

Neni 20

Urdhri për shpërblimin

1. Pas përfundimit të seancës dhe/ose shqyrtimit të shkresave dhe akteve procedurale në prokurori ose në policinë gjyqësore, prokurori i çështjes vlerëson dhe nxjerr urdhër për shpërblimin e mbrojtësit për shërbimin e ofruar për mbrojtjen e detyrueshme të pandehurit ose personit nën hetim ose të viktimës.

2. Urdhri i shpërblimit nënshkruhet nga prokurori i çështjes dhe drejtuesi i prokurorisë përkatëse.

Neni 21

Fatura shoqëruese e urdhrit

1. Fatura tatimore duhet të përmbajë këto të dhëna:

- a) numrin e faturës;
- b) datën e faturës;
- c) emrin e lëshuesit të faturës (emri i zyrës/biznesit/avokatit);
- ç) numrin e llogarisë bankare në emër të avokatit/biznesit/zyrës së tij;
- d) numrin fiskal të avokatit/biznesit;
- dh) emrin e prokurorisë dhe seksionit përkatës, shërbimin e ofruar dhe numrin e çështjes.

2. Fatura që të jetë e rregullt/zbatueshme duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur, me ngjyrë të kaltër (vula duhet të jetë në emër të avokaturës /biznesit) e pastër dhe jo e korrigjuar.

SEKSIONI I PESTË

SHPENZIMET PËR PËRKTHYESIT

Neni 22

Shpenzimet për përkthyesit

1. Pagesat për përkthyesit e jashtëm të miratuar të Ministrisë së Drejtësisë në zbatim të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave në fuqi³⁴ caktohen dhe përlllogariten në bazë faqesh.

2. Në rastet kur përkthyesi do të thirret për t'u paraqitur në prokurori ose në policinë gjyqësore për të kryer shërbime përkthimi, krahas pagesës për përkthim, u mbulohen edhe shpenzimet ditore në të njëjtën masë, referuar në kriteret për shpenzimet dhe pagesat e ekspertëve dhe deklaruesve/viktimave të normuara në këtë udhëzim.

Neni 23

Nevojat e ngutshme

Në raste të veçanta dhe për nevoja të ngutshme, me autorizim të drejtuesit të prokurorisë përkatëse, mund të realizohet pagesa sipas tarifave të parashikuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë në fuqi, edhe për përkthyesit, të cilët nuk janë përfshirë në listën e përkthyesve të jashtëm të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 24

Shpërblimi i përkthyesit

Përkthyesi shpërblehet për:

a) Përkthimin e shkresave dhe akteve procedurale, sipas tarifave për faqe/lekë;

³⁴ Shih, udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave nr.3165 datë 12.05.2004 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët" (i ndryshuar) në fuqi, bashkëlidhur.

b) Përkthimin në seancën e pyetjes të pandehurit, personit nën hetim, deklaruesit, viktimës sipas kërkesave ligjore të prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore, sipas tarifave orë/lekë.

Neni 25

Dokumentacioni për shpërblimin e përkthyesit

1. Përkthyesi i angazhuar për herë të parë është i detyruar që në prokurori të dorëzojë këto dokumente:

- a) Certifikatën e regjistrimit të veprimtarisë/përkthimit;
- b) Certifikatën e numrit fiskal;
- c) Kopjen e llogarisë bankare në emër të përkthyesit/biznesit;
- ç) Kopjen e letërnjoftimit.

Neni 26

Urdhri për shpërblimin

1. Pas përfundimit të seancës, apo përkthimit të shkresave/akteve procedurale, me dorëzimin e akteve/shkresave të përkthyer, prokurori i çështjes nxjerr urdhër për shpërblimin e përkthyesit të caktuar.

2. Urdhri i shpërblimit nënshkruhet nga prokurori i çështjes dhe drejtuesi i prokurorisë përkatëse.

Neni 27

Fatura shoqëruese e urdhrin

1. Fatura duhet t'i përmbajë këto të dhëna:

- a) numrin e faturës tatimore;
- b) datën e faturës;
- c) emrin e lëshuesit të faturës tatimore (emri i përkthyesit/biznesit);
- ç) numrin e llogarisë bankare në emër të përkthyesit/biznesit;
- d) numrin fiskal të biznesit;
- dh) emrin e prokurorisë dhe/ose seksionit përkatës, shërbimin e ofruar dhe numrin e çështjes;

2. Fatura që të jetë e rregullt/zbatueshme duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur, me ngjyrë të kaltër (vula duhet të jetë në emër të përkthyesit /biznesit) e pastër dhe jo e korrigjuar.

KREU III

ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT DHE PROCEDURA E PAGESËS/SHPËRBLIMIT

Neni 28

Procedura për dorëzimin dhe administrimin e dokumentacionit për shpërblimet

1. Urdhrat e shpërblimit të plotësuar dhe të nënshkruara sipas parashikimeve në këtë udhëzim nga, ekspertit sipas Kreut III, deklaruesi/viktima sipas Kreut IV, avokati/mbrojtësi sipas Kreut V dhe përkthyesi sipas Kreut VI, së bashku me faturat përkatëse, secili i dorëzon tek zyra e financës në prokurorinë e juridiksionit të përgjithshëm përkatëse.

2. Dorëzimi i dokumentacionit për muajin paraardhës duhet të bëhet nga data 01 (një) deri më 05 (pesë) të muajit vijues. Përfundimisht, në rrethana të veçanta kur nuk është e mundur përmbushja e këtyre afateve për dorëzimin e dokumentacionit sipas normimit në pikën 1 të këtij neni, pagesa mund të realizohet me kërkesë të arsyetuar, me dhënien e pëlqimit/miratimit nga drejtuesi i prokurorisë përkatëse.

3. Zyra e Financës, pas kontrollit dhe verifikimit të të dhënave, përgatit tabelën përmbledhëse, për secilin subjekt, e cila nënshkruhet nga drejtuesi i prokurorisë, si dhe shefi i zyrës së financave. Tabela përmbledhëse dhe dokumentacioni përcjellës dorëzohet tek thesari i shtetit. Dorëzimi i tabelës me dokumentacionin e nevojshëm për muajin paraardhës bëhet deri më datën 10 të muajit vijues.

Neni 29

Procedura e shpërblimit/pagesës për secilin subjekt

1. Zyra e financës njofton secilin subjekt (ekspertin, deklaruesin/viktimën, avokatin/mbrojtësin e detyrueshëm, përkthyesin) për tërheqjen nga secili të pagesës/shpërblimit.

a) Njoftimi shoqërohet me një kopje të vertetimit të dhënë nga banka që konfirmon/vërteton kryerjen e pagesës.

b) Njoftimi bëhet brenda 5 (pesë) ditëve nga kryerja e pagesës, në rrugë postare, elektronike, si dhe me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

2. Pagesa/shpërblimi që i takon secilit subjekt bëhet nga fondi i caktuar në llogarinë përkatëse të prokurorisë, në zbatim të urdhrat të prokurorit të çështjes të miratuar nga drejtuesi i prokurorisë përkatëse.

3. Në rastin kur limiti mujor është i pamjaftueshëm për likuidimin e plotë të shumës së shpërblimit për secilin ose ndonjërin subjekt, likuidimi shtyhet në muajin pasardhës, sipas radhës kronologjike të urdhrave të prokurorit të njoftuara dhe të plotësuar me dokumentacionin tatimor provues.

4. Në rast të mungesës së fondeve buxhetore për pagesën e të gjithë shpenzimeve të përllogaritura, Zyra e Financës kontabilizon çdo detyrim të mbartur, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe planifikon fondet e nevojshme për shlyerjen e këtyre detyrimeve, për periudhat e ardhshme buxhetore.

Neni 30

Procesverbali për shpenzimeve procedurale penale

(Shtuar pika 4 e këtij neni me nenin 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr.06/2021)

1. Shpenzimet procedurale, të kryera në fazën e hetimeve paraprake, sipas zërave dhe llojeve të tyre, para përfundimit të hetimeve, përshkruhen në një akt përmbledhës "Procesverbal për shpenzimet procedurale në hetimet paraprake", në zbatim të ligjit³⁵ dhe të këtij udhëzimi, i emërtuar, bashkëlidhur, *Aneksi Nr.1*.

2. Në fashikullin e secilës çështje të dërguar me kërkesë për në gjykatë³⁶, vendoset/administrohet origjinali i "Procesverbalit për shpenzimet procedurale në hetimet paraprake" dhe aktet/dokumentat provuese.

3. Në fashikullin që mban prokurori, krahas akteve të tjera, vendoset dhe administrohet kopja e "Procesverbalit për shpenzimet procedurale në hetimet paraprake" dhe bashkëlidhur urdhrat e pagesave, faturat ose dokumenta të tjera provuese të shpenzimeve procedurale, sipas listimit të zërave dhe llojeve në procesverbalin përkatës.

4. Një kopje e "Procesverbalit për shpenzimet procedurale në hetimet paraprake" administrohet në Zyrën e Financës të prokurorisë përkatëse, ku ndodhen dhe urdhër pagesa, fatura ose dokumenta të tjera provuese të shpenzimeve procedurale, të dhëna të cilat sipas listimit të veprave penale, zërave dhe llojeve të shpenzimeve në procesverbalin përkatës, mbahen nga nëpunësi/specialist i financës në "Regjistrin e shpenzimeve procedurale penale" sipas modelit lidhja nr.2, bashkëlidhur.

KREU IV

DISPONIME TË TJERA TË PROKURORIT PËR SHPENZIMET PROCEDURALE

³⁵ Shih, nenet 115/1, 116, 485/2 e vijues të Kodit të Procedurës Penale

³⁶ Shih, nenin 331 në lidhje me nenet 328, 329/a, 400, 406/a e 406/dh të K.Pr.Penale.

Neni 31

Garantimi i pagimit të shpenzimeve procedurale

Për të garantuar pagimin e shpenzimeve procedurale, prokurori për secilin procedim/çështje që ka në ndjekje vlerëson kushtet/kriteret ligjore³⁷ dhe i kërkon gjykatës vendosjen e sekuestros konservative në pasurinë e të pandehurit/personit nën hetim dhe/ose të paditurit civil në procesin penal, për të garantuar që në fazën e hetimeve paraprake pagimin e shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti.

Neni 32

Disponimi i prokurorit në pushimin e çështjeve që ndiqen mbi ankim³⁸

1. Në përfundim të hetimeve, për kundravajtjet penale që ndiqen mbi ankim, kur prokurori vendos pushimin e çështjes për shkak se fakti nuk ekziston³⁹ ose i pandehuri nuk e ka kryer, në pjesën arsyetuese dhe në dispozitivin e vendimit shprehet se i ngarkohen ankuesit detyrimi me pagimin e shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti.

2. Në rastet kur vendoset pushimi i çështjes për shkak të tërheqjes së ankimit, prokurori i çështjes në pjesën arsyetuese dhe dispozitivin e vendimit, shprehet se i ngarkohet ankuesit shuma e shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti, përveç se kur në aktin e tërheqjes është parashikuar me marrëveshje që shpenzimet procedurale janë tërësisht ose pjesërisht në ngarkim të personit kundër të cilit është bërë ankimi.

Neni 33

Kërkesa në shqyrtimin gjyqësor

1. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, prokurori në konkluzionet përfundimtare, krahas kërkesave për deklarimin e fajësisë së të pandehurit dhe për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, i

³⁷ Shih, po aty, nenin 270 “Kushtet dhe efektet e masës” dhe nenin 271 “Vendimi i gjykatës për sekuestron” lidhur me sekuestron konservative.

³⁸ Shih, nenin 284 “Ankimi” e vijues të K.Pr.Penale

³⁹ Shih, nenin 398 “Detyrimi i ankuesit me shpenzimet dhe me dëmet”, pika 1 parashikon: “1. Kur gjykata vendos pafajësinë e të pandehurit për një vepër penale që ndiqet mbi ankim, sepse fakti nuk ekziston ose se i pandehuri nuk e ka kryer, ankuesi detyrohet me pagimin e shpenzimit të procedimit të bëra nga shteti, si dhe me shpenzimet dhe me shpërblimin e dëmit në dobi të të pandehurit dhe të paditurit civil.”

parashtron gjykatës kërkesën edhe për detyrimin e të pandehurit/ve dhe/ose të paditurit civil apo ankuesit, për të paguar shumën e shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti.⁴⁰

2. Kundër vendimit të gjykatës që nuk pranon kërkesën për disponimin lidhur me shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti, prokurorit mund të bëjë ankim në gjykatën më të lartë, sipas rasteve të parashikuara në ligj⁴¹.

Neni 34

Ekzekutimi i vendimit penal të formës së prerë

Me marrjen formë të prerë vendimi gjyqësor penal, prokurori i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale, krahas disponimeve të tjera, në pjesën arsyetuese dhe në pjesën urdhëruese përcakton zyrën e përmbarimit shtetëror përkatëse për ekzekutimin e detyrimit të vendosur nga gjykata⁴² për shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti.

Neni 35

Ankimi për shpenzimet procedurale

Kundër vendimit gjyqësor penal të formës së prerë të vënë në ekzekutim nga prokurori për shpenzimet procedurale mund të ushtrojnë ankim të interesuarit ose mbrojtësit e tyre në gjykatën që ka dhënë vendimin, e cila procedon sipas rregullave të caktuara në ligj⁴³.

Neni 36

Informimi për shpenzimet procedural

(Ndryshuar pikat 1 dhe shtuar pika 2 e këtij neni me nenin 3 të udhëzimit përgjithshëm nr.06/2021)

1. Shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti raportohen periodikisht, për çdo procedim penal, në shumën/vlerën totale në rubrikën përkatëse të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjes, me fillimin e funksionimit të tij.

⁴⁰ Shih nenet 378, 485 paragrafi “3. Në vendimin përfundimtar gjykata cakton detyrimin për pagimin e shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti”; nenin 393 “Detyrimi për shpenzimet”, nenin 397 “Detyrimi i palëve private me shpenzimet procedurale”, dhe nenin 398 “Detyrimi i ankuesit me shpenzimet dhe me dëmet” të Kodit të Procedurës Penale.

⁴¹ Shih nenet 408, 412, 415, 422, 425 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

⁴² Shih, po aty, nenet 463 paragrafi 1 dhe 486 paragrafi 1.

⁴³ Shih nenet 487, 471 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

2. Zyrat e Financës në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm raportojnë periodikisht shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti, sipas veprave penale e zërave përkatëse për çështjet e përfunduara dhe vlera/shuma totale e tyre, për periudhat 3, 6, 9 mujore e vjetore, në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financës në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila përllëgarit kostot e shpenzimeve procedurale penale sipas veprave penale e zërave përkatëse për procedimet penale të përfunduara dhe vlera/shuma totale e tyre sipas prokurorive.

KREU V

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 37

Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore *(Ndryshuar me nenin 4 të udhëzimit të përgjithshëm nr.06/2021)*

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit⁴⁴ dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit, nëpunësve të prokurorisë dhe/ose drejtuesit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, sipas ligjit.

Neni 38

Zbatimi dhe mbikëqyrja *(Shtesa në pikën 1 dhe ndryshuar pika 2 e këtij neni me nenin 5 të udhëzimit të përgjithshëm nr.06/2021)*

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve në strukturat përkatëse, kancelarët, nëpunësit zbatues (sektori financës) dhe/ose nëpunësit/specialistët përkatës pranë prokurorive përkatëse, si dhe nga drejtuesit e prokurorive të gjithë niveleve të juridiksionit të përgjithshëm⁴⁵.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm ngarkohen drejtuesit e prokurorive, kancelarët dhe nëpunësit zbatues (sektori i financës) në prokuroritë me juridiksion të

⁴⁴ Shih, nenin 148/d paragrafi 1 i Kushtetutës dhe nenet 101 pika 1 shkronja “a” “b” dhe 102 pika 1 shkronjat “c” “ç”, “d” “dh”, “e”, “g”, “i”, “j”, “nj”; pika 2 shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit nr.96/2016, i ndryshuar me ligjin nr.48/2019 dhe neni 89 e vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

⁴⁵ Shih nenin 46 pika 1 dhe nenin 6 pika 2 të ligjit nr.97/2016.

përgjithshë⁴⁶, prokurori/personeli i caktuar pranë Drejtorisë së Koordinimit Institucional dhe Sekretari i Përgjithshëm, në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm.⁴⁷

Neni 38/1

Dispozitë kalimtare

(Shtuar neni 38/1 me nenin 6 të udhëzimit të përgjithshëm nr.06/2021)

1. Plotësimi dhe raportimi i të dhënave në “Regjistrin e shpenzimeve procedurale penale” sipas modelit lidhja nr.2, bashkëlidhur, sipas parashikimeve në nenin 2 që shton pikën 4 në nenin 30 dhe në nenin 3 që shton pikën 2 në nenin 36 të udhëzimit, fillon nga data 1 janar 2021.

Neni 39

Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM

⁴⁶ Shih po aty, nenin 43 shkronja “dh”.

⁴⁷ Po aty neni 46 pika 4.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR

Procesverbal mbi Shpenzimet Procedurale në hetimet paraprake të procedimit penal Nr. ____
të vitit _____

Sot me datë _____

Unë____, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor____, pasi studiova aktet e procedimit penal Nr. ____ të vitit____, në mbështetje të neneve 485-487 të Kodit të Procedurës Penale, në zbatim të ligjit nr.97/2016, dt.06.10.2016 dhe Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.____, dt.____ »Për shpenzimet procedurale penale në prokurorit juridiksion të përgjithshëm», mbaj këtë procesverbal mbi shpenzimet procedurale në hetimet paraprake, si më poshtë vijon :

NR	AKTI	VLERA	SASIA	SHUMA
1 .	Kqyrjet e vendeve			
2.	Ekspertime mjeko-ligjore kimik			
3.	Ekspertim toksikologjik			
4.	Ekspertime ekonomike			
5.	Ekspertime teknike thike			
6.	Ekspertime autoteknike			
7.	Ekspertime			

8.	Ekspertime daktiloskopike			
9.	Ekspertime balistike			
10.	Vleresim provash materiale			
11.	Ekspertim psikologjik			
12.	Ekspertime kimik			
13.	Bashkëpunimi ndërkombëtar			
14.	Mbrojtës kryesisht			
15.	Njoftime postare			
16.	Përkthime dhe Noteri			
17.	Kancelari; ➤ Kapak dosje ➤ Fletë të bardha (fotokopje, printime) ➤ Njoftime			
18.	Shpenzime automjeti			
19.	Shpenzime te tjera			
20.				

VLERA TOTALE NË LEKË ____ (_____ mijë) lekë.

PROKURORI